

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7960
E mërkurë, 25 dhjetor 2024
Çmimi 0.50 €

Raporti i FMN-së
vlerëson sërish
punën e BQK-së FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AVOKATI I POPULLIT SHPREH SHQETËSIM PËR GJYKATËN SPECIALE PËR MOSBASHKËPUNIM: KA NJË MBYLLJE TË PLOTË FAQE 4-5



Avokati i Popullit i Kosovës, Naim Qelaj, ka thënë se si institucion i kanë marrë me shqetësim dyshimet për shkelje të procedurave në rastin gjyqësor ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës me seli në Hagë. Në konferencën e fundvitit, Qelaj tha se është i shqetësuar sa iu takon pretendimeve të ekipeve mbrojtëse të ish-udhëheqësve të UÇK-së, Hashim Thaçi,

Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Ai tha se ka komunikuar me Avokatin e Popullit që vepron në kuadër të Dhomave të Specializuara për këto shqetësime porse ai, sipas tij, nuk ka shprehur interesim për bashkëpunim

EDHE NJË VIT PA MIRATIMIN E DISA LIGJEVE TË SHUMËKËRKUARA NGA SHOQËRIA CIVILE F. 4



MEMLI KRASNIQI: RINIA, AMBASADORE E MESAZHIT TONË SE 'KOSOVA MUNDET MA MIRË' F. 7



AKTUALE



ISH-PRESIDENTI AMERIKAN BILL CLINTON SHTROHET NË SPITAL F. 2

FOL-I IDENTIFIKON MANGËSITË PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR PRIVATËSINË NË INSTITUCIONET PUBLIKE F. 5

RRITET INTERESIMI PËR ARMËMBAJTJE NË KOSOVË, MBI 14 MIJË KËRKESA GJATË VITIT 2024 F. 6

EKONOMI



KEDS-I: RITJA TEJ MASE E KONSUMIT TË RRYMËS KA SHKAKTUAR NJË VARG MBINGARKESASH NË KOSOVË F. 8

PËRURORHET RRUGA ZHUR-DRAGASH-DRAGASH-BROD, ME GJATËSI 42 KILOMETRA F. 8

SPORT



TAKIM INFORMUES MBI LIGJIN E SPONSORIZIMIT PËR KLUBET E FUTBOLLIT F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ish-presidenti amerikan Bill Clinton shtrohet në spital

UASHINGTON, 24 DHJETOR - Ish-presidenti amerikan Bill Clinton është shtruar të hënën në Spitalin Universitar MedStar Xhorxhtaun në Uashington pasi është raportuar se kishte ethe.

78-vjeçari u shtrua në spital pasdite "për analiza dhe vëzhgim", ka thënë në një deklaratë Angel Urena, zëvendëseshë i stafit të

Clintonit. "Ai mbetet në gjendje të mirë shpirtërore dhe është shumë mirënjohës për kujdesin e shkëlqyer që po merr", tha Urena, raporton "Associated Press".

Clintoni, një demokrat që shërbeu dy mandate president nga janari 1993 deri në janar 2001, foli në Konventën Kombëtare Demokratike në Çikago këtë

verë dhe bëri fushatë përpara zgjedhjeve të nëntorit për përpjekjen e pasuksesshme të zëvendës-presidentes demokrate Kamala Harris në garën për Shtëpinë e Bardhë. Në vitet që kur Clintoni ka lënë Shtëpinë e Bardhë, ai ka pasur disa probleme shëndetësore.

Në vitin 2004 iu nënshtrua një operacioni në zemër pasi

përjetoi dhimbje të vazhdueshme në gjoks dhe vështirësi në frymëmarrje. Clintoni u kthye në spital për një operacion në mushkëri në vitin 2005, kurse në vitin 2010 iu vendosën dy stenta në një arterie koronare.

Në vitin 2021 ish-presidenti u shtrua në spital për gjashtë ditë në Kaliforni, ndërsa po trajtohej për një infeksion që



nuk lidhej me Covid-19, në kohën kur pandemia ishte ende në kulmin e saj.

Kremlini hedh poshtë raportimet se gruaja e Assadit ka kërkuar divorc

MOSKË, 24 DHJETOR - Gruaja e presidentit të rrëzuar sirian, Bashar al-Assad, nuk ka kërkuar divorc, ka bërë me dije Kremlini. Raportimet në mediet turke kanë sugjeruar se Asma al-Assad, e lindur në Britani të Madhe, ka kërkuar t'i japë fund martesës dhe të largohet nga Rusia, vend që asaj dhe burrit të saj ia kanë miratuar azilin, pasi një koalicion i rebelëve e ka rrëzuar regjimin e ish-presidentit dhe e ka marrë kontrollin e Damaskut.

I pyetur për këto raportime në një sallë konferencash, Dmitry Peskov, ka thënë se ato "nuk janë në përputhje me realitetin". Ai i ka mohuar edhe raportimet se Assadi është

izoluuar në Moskë dhe që i janë ngrirë asetet.

Rusia ka qenë aleate e palëkundur e regjimit të Assadit dhe i ka ofruar mbështetje ushtarake gjatë luftës civile.

Mirëpo në raportimet e medieve turke është thënë se familja e Assadit është duke jetuar nën kufizime të ashpra në kryeqytetin rus, dhe që Asma ka kërkuar divorc dhe që kërkon të kthehet në Londër. Ajo ka shtetësi siriane dhe britanike, mirëpo Ministria e Jashtme britanike ka bërë me dije më herët se asaj nuk do t'i lejohet kthimi në Britani.

Ministri britanik David Lammy ka thënë më herët gjatë muajit në parlament se "ajo është



individ i sanksionuar dhe nuk është i mirëpritur në Mbretërinë e Bashkuar".

Në një deklaratë të lëshuar

javën e kaluar, Bashar al-Assad ka thënë se nuk ka synuar të largohet kurrë nga Siria, mirëpo është transferuar nga baza

ushtarake ruse, me kërkesë të Moskës.

Asma al-Assad, 49-vjeçare, ka lindur në Britani nga prindër sirianë dhe është rritur në perëndim të Londrës. Ajo është zhvendosur në Siri më 2000 dhe në moshën 25-vjeçare është martuar me burrin që ka sot.

Më 2018 ajo ka thënë se po trajtohet për kancer në gj, ndërsa një vit më vonë ka thënë se është shëruar plotësisht.

Në maj të këtij viti ajo është raportuar të jetë diagnostikuar me leukemi dhe ka nisur trajtimin.

Përmes një deklaratë ishte bërë me dije se ajo do të tërhiqet përkohësisht nga të gjitha angazhimet publike.

Ligji për Gjuhët në Maqedoninë e Veriut pritet të shqyrtohet në mars të vitit tjetër



SHKUP, 24 DHJETOR - Kryetari i Gjykatës Kushtetuese në Maqedoninë e Veriut, Darko Kostadinovski, ka njoftuar se seanca përgatitore e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve pritet të mbahet në periudhën prej 19 deri më 21 mars të vitit të ardhshëm. Sipas tij, janë propozuar mbi 20 emra si ekspertë të së drejtës kushtetuese, të drejtës ndërkombëtare dhe ish-gjykatës nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilët do të ftohen për t'i dhënë mendimet e tyre. Finalizimi dhe publikimi i këtyre propozimeve, së bashku

me çështje kontestuese juridike, pritet të bëhen të martën, më 24 dhjetor. "Kushdo që mendon se sundimi i ligjit dhe shteti ligjor do të pengohen nga manipulimet, presionet dhe ndikimet politike, e ka të kotë! Askush nuk është mbi Kushtetutën. Të gjithë janë të detyruar ta respektojnë Kushtetutën", ka deklaruar Kostadinovski në një konferencë për medie.

Ai shtoi se Kushtetuesja ka kërkuar edhe "këshilla miqësore (amicus curiae)" nga Komisioni i Venecias, që do të miratohen në seancën e 14 dhe 15 marsit, dhe

do të publikohen disa ditë më vonë (17 - 18 mars), para seancës.

Më 11 dhjetor Gjykata Kushtetuese vendosi ta shtyjë seancën për vlerësimin e ligjshmërisë së Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve për shkak se munguan dy gjykatësit shqiptarë, Osman Kadriu dhe Naser Ajdari, duke e bojkotuar kështu procesin. Kostadinovski deklaroi se pret që të dy gjykatësit të jenë të pranishëm në seancën e ardhshme dhe t'i paraqesin argumentet e tyre juridike.

NASA, mision për ta studiuar nga afër diellin

UASHINGTON, 24 DHJETOR - Një sondë e Agjencisë amerikane Hapësinore (NASA) është duke bërë përpjekje të bëjë histori duke bërë afrimin më të madh ndonjëherë me diellin.

Sonda diellore Parker synon të zhytet në atmosferën e jashtme të këtij ylli, duke iu rezistuar temperaturave brutale dhe

rezatimit ekstrem.

Pajisja nuk do të ketë sinjal për disa ditë, sa të jetë e ekspozuar në flakët e diellit, dhe shkencëtarët do të jenë në pritje të sinjalit më 28 dhjetor, nëse sonda nuk do të digjet. I gjithë studimi është duke u bërë ashtu që njerëzimi të kuptojë se si funksionon dielli.

Ky studim ka nisur më 2018, duke pasur në qendër sistemin diellor.

Sondat kanë qarkulluar rreth diellit, në distanca shumë të largëta për 21 herë rresht, mirëpo misioni aktual mund të shënojë rekord.

Nëse gjithçka shkon si duhet, sonda do t'i afrohet diellit në

distancë prej 6.2 milionë kilometrash, më të afërtën ndonjëherë.

Sondës do t'i duhet të durojë temperatura mbi 1.400 gradë celsius dhe rrezatim të jashtëzakonshëm. Shkencëtarët besojnë që përmes këtij studimi të zbulojnë më shumë për diellin dhe sistemin e tij.



Avokati i Popullit shpreh shqetësim për Gjykatën Speciale për mosbashkëpunim: Ka një mbyllje të plotë

Avokati i Popullit i Kosovës, Naim Qelaj, ka thënë se si institucion i kanë marrë me shqetësim dyshimet për shkelje të procedurave në rastin gjyqësor ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës me seli në Hagë. Në konferencën e fundvitit, Qelaj tha se është i shqetësuar sa iu takon pretendimeve të ekipeve mbrojtëse të ish-udhëheqësve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Ai tha se ka komunikuar me Avokatin e Popullit që vepron në kuadër të Dhomave të Specializuara për këto shqetësime porse ai, sipas tij, nuk ka shprehur interesim për bashkëpunim

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 24 dhjetor - Avokati i Popullit i Kosovës, Naim Qelaj, ka thënë se si institucion i kanë marrë me shqetësim dyshimet për shkelje të procedurave në rastin gjyqësor ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës me seli në Hagë. Në konferencën e fundvitit, Qelaj tha se është i shqetësuar sa iu përket pretendimeve të ekipeve mbrojtëse të ish-udhëheqësve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Në muajt e fundit ekipet mbrojtëse kanë ngritur dyshime për animin që, sipas tyre, paneli i gjykatësve po tregon në gjykimin ndaj krerëve të UÇK-së. “Unë kam shprehur shqetësim në raport me ekipet mbrojtëse. Çdo hetim i mbrojtjes lejon

mundësi për dyshim dhe ndikim, dhe i qëndroj mbështetur kësaj deklaratë. Do të jetë në interes të Avokatit të Popullit që të monitorojë disa nga seancat, sepse të gjitha nuk mundemi për shkak të kostos. Avokati i Popullit mund të kryejë vetëm një rol atje, si mik i gjykatës”, u shpreh Qelaj. Ai tha se ka komunikuar me Avokatin e Popullit që vepron në kuadër të Dhomave të Specializuara për këto shqetësime porse ai, sipas tij, nuk ka shprehur interesim për bashkëpunim. “Kam parë që nuk ka shprehur interesim për një bashkëpunim dhe, për më tepër, nuk ka ofruar as informata të cilat mund të jenë publike. Ai është thirrur gjithmonë në konfidencialitet... Ka një mbyllje të plotë të atij institucioni në raport me mua si Avokat i Popullit dhe besoj edhe me publikun”, ka deklaruar Qelaj. Në muajin nëntor ekipet

mbrojtëse dorëzuan në Dhomat e Specializuara shkresa zyrtare në emër të klientëve të tyre duke shprehur shqetësimet për gjykim të padrejtë dhe me shkelje të parimeve ndërkombëtare të drejtësisë.

Në kuadër të Dhomave të Specializuara vepron një Avokat i Popullit. “Roli i tij është monitorimi, mbrojtja dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar”, thuhet në uebfaqen e këtij institucioni.

Ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, po gjykojnë për dyshimet për

krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ata akuzohen për krime të luftës: arrestim dhe ndalim i paligjshëm, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme.

Ndërkaq, krimet kundër njerëzimit që ata akuzohen se kanë kryer janë: përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë e personave.

Krimet dyshohet se janë kryer nga marsi i vitit 1998 deri në shtator 1999, në disa lokacione të Kosovës, por edhe në Kukës dhe Cahan të Shqipërisë.

Të gjithë janë deklaruar të pafajshëm.

Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë ngriti aktakuzë të re kundër Thaçit

dhe të tjerëve në fillim të dhjetorit, dhe i akuzon ata për “përpjekje të paligjshme për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në gjykimin e krimeve të luftës ndaj Thaçit dhe të tjerëve”.

Gjykata Speciale u themelua në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por vepron me personel ndërkombëtar dhe ka selinë në Hagë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Hargreaves, thirrje KQZ-së: Respektojeni ligjin, jo interesat politike

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, kërkoi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve t'i respektojë procedurat ligjore në rastin e certifikimit të Listës Serbe. “I bëj thirrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës që të sigurojë se procesi zgjedhor të kryhet me integritet dhe bazuar në procedura të drejta ligjore, e jo mbi interesat politike”, shkroi Hargreaves.

Më 23 dhjetor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk e certifikoi Listën Serbe, partinë më të madhe të serbëve në Kosovë - për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit.

Përfaqësues të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dolën kundër certifikimit



të kësaj partie - e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar - duke përmendur që kjo parti nuk

e njeh shtetin e Kosovës, dhe atij nuk i referohet me emrin zyrtar, por si “Kosova dhe Metohia”.

Në reagimin e tij, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Hargreaves, kërkoi nga KQZ-ja

dhe anëtarët e saj të jenë gjithëpërfshirës dhe transparentë. “Presim që KQZ-ja dhe të gjithë anëtarët e saj ta vlerësojnë certifikimin e Listës Serbe sipas zbatimit gjithëpërfshirës, transparent dhe të qëndrueshëm të rregulloreve përkatëse”, tha Hargreaves.

Lista Serbe e ka konsideruar vendimin të kundërligjshëm. Presidenti serb Aleksandar Vuçiq ka pretenduar të hënën se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, po tenton “ta eliminojë kundërshtaren e vetme” në Kosovë, Listën Serbe.

Më vonë Vuçiqi ka thënë se ka biseduar edhe me ministrin e Jashtëm rus, Sergei Lavrov, për ato që i ka konsideruar shkelje të ligjit ndërkombëtar nga ana e Prishtinës, duke ia pamundësuar Listës Serbe pjesëmarrjen në zgjedhje.



Edhe një vit pa miratimin e disa ligjeve të shumëkërkuara nga shoqëria civile

Me afrimin e fundit të vitit, afrohet edhe fundi i mandatit të deputetëve aktualë të Kosovës. A e dini se disa ligje thelbësore ata nuk i kanë miratuar? Në rreth 60 mbledhje të Qeverisë së Kosovës dhe rreth 40 seanca plenare në Kuvend gjatë 2024-s, ligjberësit në Kosovë nuk arritën t'i miratojnë disa nga ligjet e shumëkërkuara nga shoqëria civile në vend. Për më tepër, kishte edhe ligje që nuk arritën të përfshiheshin në agjendën legislative për këtë vit, si Ligji i Punës

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Me afrimin e fundit të vitit afrohet edhe fundi i mandatit të deputetëve aktualë të Kosovës. A e dini se disa ligje thelbësore ata nuk i kanë miratuar? Në rreth 60 mbledhje të Qeverisë së Kosovës dhe rreth 40 seanca plenare në Kuvend gjatë 2024-s, ligjberësit në Kosovë nuk arritën t'i miratojnë disa nga ligjet e shumëkërkuara nga shoqëria civile në vend. Për më tepër, kishte edhe ligje që nuk arritën të përfshiheshin në agjendën legislative për këtë vit, si Ligji i Punës. Me këtë ligj përcaktohet, ndër të tjera, pushimi i lehonisë, që është ndër arsyet kryesore përse organizata të ndryshme joqeveritare në Kosovë kërkojnë ndryshim të tij. Disa, si Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK), kanë dalë në vitet e fundit edhe me propozime se si mund të ndryshohet ai. Ligji është kritikuar edhe për vjetërsinë e tij dhe mungesën e adresimit të problemeve që mundësojnë abuzimin me të drejtat e punëtorëve - vendore dhe migrantë.

Por, në fund, ligji - për të cilin janë kërkuar e premtuar ndryshime që nga viti 2012 - nuk u përfshi në agjendën legislative. "Qeveria e Kosovës po mbështet drejtpërdrejt vazhdimin e shkëlqeve të të drejtave të grave dhe burrave", tha Brikenë Hoxha, drejtoreshë e Iniciativës Kosovare për Stabilitet, në një protestë të thirrur pas mospërfshirjes së Ligjit të Punës në kalendarin legjislativ për vitin 2024. Për dallim nga ky ligj, për miratimin e një tjetri u tentua disa herë gjatë vitit 2024. Ligji për Shëndet Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor (IVF) ngjalli diskutime të shumta në Kuvend dhe jashtë tij. Ai fillimisht ishte propozuar nga Qeveria e Kosovës më 27 janar të vitit 2023, ndërsa ishte miratuar në lexim të parë në Kuvend në tetor të atij viti. Gjatë këtij viti u tentua gjashtë herë të kalohej në Kuvend edhe në lexim të dytë, por kjo përpjekje dështoi secilën herë. Procesi u zvarrit për shkak të disa ndryshimeve që kërko

Visar Korenica, ish-deputet i Lëvizjes Vetëvendosje në pushtet, i cili në mandatin e ardhshëm do të kandidojë në kuadër të Listës për Familjen. Në këtë projektligj parashihet që gratë të kenë qasje në IVF pa marrë parasysh statusin e tyre - qofshin ato beqare, qofshin në një çift homoseksual apo heteroseksual. Korenica propozoi të largohen tre paragrafë, në mënyrë që fertilizimi i asistuar mjekësor të mos u mundësohej edhe grave të pamartuara dhe çiftve homoseksuale. Këto kërkesa të tij u përkrahën edhe nga disa deputetë të tjerë në Kuvendin e Kosovës. Për aktivisten e të drejtave të grave, Blenda Asllani, arsyetimet e deputetëve se me kërkesat e tyre "duan ta mbrojnë institucionin e familjes", janë të pabaza. "Ne nuk i kemi dëgjuar këta deputetë të flasin për sfidat që i kanë nënat vetushqyese, për fëmijët që rriten në shtëpi abuzuese e plot dhunë, apo për fatin e fëmijëve në strehimore. Por, krejt papritur, po i shqetëson prishja e konceptit të

familjes tradicionale. Kjo rezulton vetëm si barrë e grave beqare dhe çiftve të varfra", thotë ajo. Projektligji parasheh që IVF-ja të fillojë të aplikohet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe të hapet një bankë e qelizave riprodhuese publike. Aktualisht për kryerjen e këtyre procedurave gratë drejtohen nëpër spitale private ose në shtete të tjera. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, këto procedura u kanë kushtuar kosovarëve mesatarisht pesë milionë euro në vit. Me arsyen e njëjtë - për "mbrojtjen e institucionit të familjes" - ka ngecur deri më tani edhe Kodi Civil. Mospajtimit e deputetëve lidhen me nenin që do të mundësonte hartimin e një ligji të posaçëm, përmes të cilit do të lejohej regjistrimi i "bashkësive civile" ndërmjet personave me gjini të njëjtë. Që nga 16 marsi i vitit 2022 ky Kod nuk ka dalë në Kuvend për miratim, megjithëse Ministria e Drejtësisë ka përsëritur disa herë deklaratën se ai do të dalë në Kuvend "së shpejti". Pas interesimit të REL-it, Ministria e Drejtësisë bëri me dije se ka bërë ndryshime në nenin për bashkësitë civile mes personave të gjinisë së njëjtë, mirëpo nuk ka dhënë detaje se çfarë ndryshimesh janë bërë. Kristian Rrasaj, ekspert ligjor në Qendrën për Barazi dhe Liri

(CEL), thotë se Kodi Civil duhet ta parashohë martesën mes personave të gjinisë së njëjtë, e jo vetëm krijimin e bashkësive civile. "Nuk mund të them specifikisht që nuk e përkrahim këtë draft. Por, mendimi ynë është që çfarëdo kodi që nuk e përfshin martesën mes personave të gjinisë së njëjtë, nuk do ta kalonte testin e kushtetutshmërisë", thotë Rrasaj. Kushtetuta e Kosovës thotë se "se në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën të krijojë familje në pajtim me ligjin". Në Kodin Civil thuhet se martesë është "bashkësi e regjistruar ligjërisht ndërmjet dy bashkëshortëve të sekseve të ndryshme", që do të thotë se ai nuk mundëson martesën midis personave të gjinisë së njëjtë. Ligji për Shëndetin Riprodhues dhe Kodi Civil kanë pasur përkrahjen e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, por jo edhe të të gjithë deputetëve të saj. Nga partitë opozitare, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) është shprehur kundër Kodit Civil. Të tjerat kanë hezituar t'i shprehin haptazi qëndrimet e tyre. Në fillim të vitit 2025, më 9 shkurt, kosovarët do të votojnë në zgjedhjet parlamentare, që do ta përcaktojnë edhe fatin për agjendat e ardhshme legislative.

Institucionet shtetërore shkelin rregullat e prokurimit publik, D+ publikon raportin e monitorimit

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Demokraci Plus (D+) ka publikuar një raport të hollësishëm mbi monitorimin e lidhjes së marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV) në nivel qendror dhe lokal, duke vërejtur disa shkelje të rënda të procedurave dhe rregulloreve të prokurimit publik nga disa institucione shtetërore.

Institucionet e monitoruara janë: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), Komuna e Prishtinës, Pejës, Vitisë dhe Prizrenit.

Sipas raportit, disa ministri dhe komuna kanë shpërdorur marrëveshjet për shërbime të veçanta për të angazhuar konsulentë për detyra që mund të ishin mbuluar nga stafi

aktual i institucioneve.

Një shembull i tillë është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), e cila, siç theksohet në raport, ka shpërblyer një konsulent që nuk kishte ofruar metodologji të punës, edhe pse kjo kërkesë ishte e detyrueshme për vlerësimin teknik të ofertës. "MMPHI ka vlerësuar me pikë maksimale një kandidat, edhe pse nuk kishte ofruar metodologji të punës", thuhet në raportin e D+.

Një tjetër problem është evidentuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), ku është angazhuar një ekspert ndërkombëtar për hartimin e një strategjie, duke shpërfillur rregullat e Ligjit për Prokurim Publik. "MINT ka eliminuar të gjithë ekspertët vendorë që kanë përvojën relevante për të aplikuar në tender", theksohet në raportin e D+.

Edhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)

është kritikuar për angazhimin e një konsulentit për kryerjen e punëve që duhej të mbulohehin nga stafi i ministrisë, si dhe për përdorimin e MShV-ve për t'i zgatur afatet për konsulentët e kontraktuar. "MKRS ka përdorur MShV-të për zgjatjen e afatit të punës për konsulentët e kontraktuar përmes prokurimit për shërbime të veçanta", theksohet në raport.

Në nivel lokal, komuna e Prizrenit ka përdorur marrëveshjet për shërbime të veçanta për të kontraktuar konsulentë për detyra administrative dhe teknike që duhej të realizoheshin nga stafi i komunës. "Komuna e Prizrenit ka shfrytëzuar MShV-të për të kontraktuar konsulentë të cilët kryejnë punë të rëndomta teknike-administrative", thuhet në raport.

Për më tepër, komuna e Pejës ka kontraktuar kandidatë të cilët kanë ofruar biznes dhe jo

si konsulentë individualë, duke shkelur kërkesat e tenderit. "Komuna e Pejës ka kontraktuar kandidatë të cilët kanë ofertuar me biznes e jo si konsulent individual", thuhet në raport.

Nga ana tjetër, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) dhe MASHTI gjithashtu janë kritikuar për mospërcaktimin e kriterëve për vlerësim teknik të ofertave dhe për përdorimin e MShV-ve për t'i zgatur afatet për punën e konsulentëve.

Komuna e Vitisë nuk i ka paraqitur saktësisht të dhënat në lidhje me vlerën e tenderit duke shkaktuar paqartësi te kandidatët e interesuar për ofertim dhe nuk ka respektuar afatin kohor për caktimin e afatit për dorëzim të ofertave sipas Ligjit për Prokurim Publik.

Edhe komuna e Prishtinës nuk ka respektuar procedurën ligjore e cila duhet të përdoret për lidhjen e MShV-ve. Komuna ka përcaktuar si kriter "tenderi

me çmimin më të ulët", ndërsa kriteri "tenderi ekonomikisht më i favorshëm" është ai që përdoret për lidhjen e MShV-ve.

Në lidhje me këto shkelje, D+ ka bërë disa rekomandime për përmirësimin e procesit të prokurimit publik. "Institucionet publike duhet t'i përdorin MShV-të vetëm për angazhimin e kandidatëve për shërbime specifike dhe të veçanta, të cilat nuk mund të mbulojnë në pozitë e vendeve të punës të definuara me Katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil", thekson raporti i D+.

Po ashtu, D+ sugjeron që Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ta rregullojë qartë kontraktimin e shërbimeve përmes MShV-ve në Ligjin e ri të Prokurimit Publik dhe që të gjitha institucionet t'i respektojnë kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Prokurimit Publik për të siguruar transparencë dhe konkurrencë të ndershme.



FOL-i identifikon mangësitë e zbatimit të Ligjit për Privatësinë në institucionet publike



PRISHTINË, 24 DHJETOR - Lëvizja FOL ka mbajtur të martën diskutimin e formatit "FOL Hapur" për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me komisionaren e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva - Dermaku, ku u diskutua në lidhje me sfidat dhe mangësitë për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave

Personale. Gjatë këtij diskutimi u prezantuan edhe gjetjet e raportit hulumtues "Niveli i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale - raport mbi rezultatet e anketave", i cili ofron një pasqyrë të situatës aktuale dhe rekomandime për përmirësimin e mbrojtjes së të dhënave në institucionet publike. Raporti theksoi një varg mangësisht, përfshirë

mungesën e politikave të privatësisë nga institucionet publike; mungesën e rregulloreve për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale; mungesën e protokolleve specifike për menaxhimin e të dhënave sensitive; mungesën e periudhave të përcaktuara për ruajtjen e të dhënave personale, dhe shumë çështje të tjera.

Rritet interesi për armëmbajtje në Kosovë, mbi 14 mijë kërkesa gjatë vitit 2024

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Në vitin 2024 interesi për armëmbajtje në vend ka qenë dukshëm i lartë. Gjatë periudhës janar - dhjetor janë regjistruar plot 14 340 aplikime nga persona fizikë, shumica e të cilëve e kanë justifikuar kërkesën për arsye të gjuetisë dhe rekreacionit. "Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë regjistruar gjithsej 14,340 aplikime për pëlqime për

blerje armësh nga persona fizikë, kryesisht për arsye të gjuetisë dhe rekreacionit", thuhet në përgjigjen e MPB-së për IndeksOnline. Megjithatë, jo gjithmonë mbajtja e armës është e përhershme. Në të njëjtën periudhë kohore, janë raportuar 4 raste sekuestrimi të lejeve të armëmbajtjes, ku një prej këtyre rasteve përfundoi me kthimin e lejes pas

heqjes së revokimit. "Janë 4 raste të sekuestrimeve të lejeve të armëve. Nga këto raste, njëra prej tyre ka pasur revokimin e lejes, por më pas leja i është kthyer pronarit pasi është hequr revokimi", thuhet në përgjigjen e MPB-së. Këto statistika pasqyrojnë një realitet ku kërkesa për armë vazhdon të rritet, njëkohësisht monitorimi i zbatimit të ligjit dhe siguria mbeten prioritare.



AAK-ja i paraqet programin Shoqatës së të Verbërve, i shtypur në alfabetin Braille

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, i ka dorëzuar programin e koalicionit kryetarit të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, Daut Tishuku, shtypur në alfabetin Braille. Me këtë rast, Haradinaj i premtoi mbështetje dhe përkrahje institucionale nëse bëhet kryeministër i vendit. "Qëllimi i këtij takimi është t'i dorëzojmë në mënyrë simbolike programin e AAK-së në shkrimin Braille, të cilin kanë mundësi ta lexojnë personat e verbër. Në kohën e qeverisjes sime kemi arritur të

bëjmë një konceptdokument për personat me aftësi të kufizuar, i cili, për fat të keq, ka mbetur në pritje. Statusi i personave me aftësi të kufizuar nuk është bërë ende. Ky është zotim. Nuk do ta koriti shtetin, lirinë e popullin tonë, duke ju lënë juve vetëm. Por, nuk jeni vetëm, as nuk do të jeni asnjëherë. Shteti është familja jonë e përbashkët dhe do t'ju siguroj që do të ndiheni të barabartë", ka thënë Haradinaj. Kryetari i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, Daut Tishuku, kërkoi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve t'i



obligojë partitë politike për një gjë të tillë. "Ne si shoqatë do të përpiqemi të krijojmë mundësi të barabarta. Kjo është një gjest dhe u ka dhënë mundësi personave të verbër ta analizojnë dhe gjykojnë programin dhe hedhjen e votës në zgjedhje. Ne kemi avokuar edhe te KQZ-ja dhe e kemi bërë obliguese, që kur të bëhet fushata, nga çdo parti politike programet të bëhen edhe për personat e verbër. Edhe përcaktimin të bëjmë vetë, por edhe votën ta hedhim në mënyrë dinjitoze dhe mos të kemi ndihmën e askujt", ka theksuar Tishuku.

Një delegacion nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit e Shqipërisë viziton Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit



PRISHTINË, 24 DHJETOR - Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, i shoqëruar nga kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Ardian Hajdaraj, nga kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, si dhe nga prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kanë pritur të martën në takim pune një delegacion nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së

Shqipërisë, kryesuar nga kreu i kësaj prokurorie, Altin Dumani. U. d. kryeprokurori Kelmendi i njoftoi të pranishmit me mënyrën e funksionimit, strukturën organizative dhe kompetencat e Prokurorit të Shtetit, në përgjithësi e konkretisht për kompetencat e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, si dhe për sfidat dhe të arriturat e këtij institucioni. Gjatë këtij takimi pati diskutime të frytshme lidhur me ngritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe

efikasitetit në luftën kundër krimit dhe forcimin e sundimit të ligjit në të dyja shtetet, si dhe pati diskutime për çështje të tjera profesionale me interes të përbashkët. Po në këtë takim u diskutua edhe për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit përmes nënshkrimit të memorandumeve, si dhe për formimin e ekipeve të përbashkëta të hetimit me qëllim të luftimit të të gjitha formave të krimit.

Për tri ditë policia identifikoi mbi 30 vetura të paregjistruara në rajonin e Prishtinës

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Policia e Kosovës ka bërë me dije se me veturën "Inteligjente" në rajonin e Prishtinës ka filluar planin për identifikimin e veturave të paregjistruara të cilat qarkullojnë në rrugë si dhe veturat e tjera që shkelin rregullat në trafik. Në njoftimin e policisë thuhet se për tri ditë të veprimit, në këtë rajon janë identifikuar mbi 30 vetura të

paregjistruara. "Policia e Rajonit të Prishtinës respektivisht, Njësi i Trafikut të Kryeqytetit, në kuadër të aktivitete të planifikuara për qëllim të sigurisë rrugore, me veturën 'Inteligjente' kanë filluar planin për identifikimin e veturave të pa regjistruara të cilat qarkullojnë në rrugë si dhe veturat tjera që shkelin rregullat në trafik. Ky sistem

kryen identifikimin automatik të menjëhershëm të veturave të paregjistruara edhe gjatë lëvizjes. Vetëm për tri ditë të veprimit, janë identifikuar mbi 30 vetura të paregjistruara. Ndaj shoferëve janë shqiptuar fletëparaqitjet sipas ligjit si dhe veturat janë përjashtuar nga trafiku duke i konfiskuar përkohësisht targat e regjistrimit", thuhet në njoftimin e policisë.



Përurohet shërbimi për Frytnim të Asistuar Mjekësor në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK, investim mbi 2 milionë euro

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti, bashkë me ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, të martën përuroan shërbimin e ri të Frytnimit të Asistuar Mjekësor, në Klinikën e Gjinekologjisë. Kryeministri Kurti deklaroi se inaugurimi i këtij shërbimi, pra mundësisë për fertilizim të asistuar, do t'i bëjë të lumtura shumë çifte në Kosovë. Ai pa nga afër aparaturën moderne e cila arrin koston rreth dy milionë euro. "Gjysma është prej Ministrisë së Shëndetësisë, gjysma është prej ShSKUK-së, me ç'rast vetëm aparatura e laboratorit të embriologjisë

është mbi një milion euro dhe, përveç kësaj, ishin edhe dy ultrazë të rinj, si dhe një pajisje e cila ishte version i kombinuar i histeroskopisë e laparoskopisë", njoftoi tutje kryeministri.

Nga Klinika e Gjinekologjisë, kryeministri Kurti u bëri thirrje të gjitha çifteve të cilët dëshirojnë që të bëhen prindër, sepse pas këtij investimi të përbashkët tash kanë një adresë publike, moderne dhe cilësore.

Shërbimi i Frytnimit apo Fertilizimit të Asistuar Mjekësor do të jetë falas për dy herët e para, ndërkaq pas dy herëve të para ai do të kushtojë 670 euro, dukshëm më lirë se shërbimi në sektorin privat që ka çmim rreth 3 000 euro.



Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, tha se punën më të madhe e ka bërë reparti, sidomos kjo klinikë me drejtorin Zef Ndrejaj, për çka falënderoi gjithë stafin e Klinikës Gjinekologjike për punën e shkëlqyer.

Përgëzime për punën pati edhe kryeministri, i cili falënderoi stafin, në veçanti shefin e repartit, Leandrit Bejtullahu, për punën dhe kontributin ndër vite. "Sidomos tash i përgëzoj që kanë fituar këtë investim, këtë

aparaturë që do të bëjë të mundur e të lumtur shumë çifte nga anembanë vendi ynë, të cilat do të vijjnë këtu e të cilët kanë vuajtur shumë, sepse kanë dashur të bëhen prindër, të bëhen baba e nënë, por nuk kanë mundur. Tash e kanë adresën e cila e garanton shërbimin publik dhe cilësor", përmbylli kryeministri.

Në këtë inaugurim bashkë me kryeministrin Kurti dhe ministrin Vitia të pranishëm ishin edhe drejtori i Klinikës Gjinekologjike, Zef Ndrejaj, zëvendësministria e Shëndetësisë, Dafina Gexha, deputetët e Kuvendit, Haxhi Avdyli dhe Fatmire Kollçaku, drejtori i QKUK-së, Osman Hajdari dhe drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi.

Memli Krasniqi: Rinia, ambasadore e mesazhit tonë se 'Kosova mundet ma mirë'

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në një tubim madhështor me rininë, tha se vizioni i PDK-së për një Kosovë më të mirë nuk mund të realizohet pa angazhimin e Rinisë Demokratike të Kosovës. Krasniqi është shprehur se rinia është bartëse e shpresës për një të ardhme më me perspektivë. "Jini ambasadorët e mesazhit tonë, kampionët e çështjes sonë dhe udhëheqësit e ekipit tonë. Teksa shikoj përreth kësaj sale, unë shoh të ardhmen e Kosovës. Shoh udhëheqës, aktivistë dhe nismëtarë të ndryshimit. Shoh shpresë, qëndrueshmëri dhe vendosmëri. Prandaj, le të ecim përpara të gjithë së bashku me besim dhe qëllim. Çdo arritje e madhe fillon me një ëndërr, por realizohet



nëpërmes veprimit. Ëndërroni shumë, punoni fort dhe kurrë mos humbisni besimin në fuqinë e potencialit tuaj. Kosova ka nevojë për ju, sepse me ju Kosova mundet ma mirë", tha ai. Krasniqi theksoi se vizioni i PDK-së është i guximshëm dhe transformues, që i prin në zgjedhjet e 9 shkurtit kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, një udhëheqës që kupton

sfidat me të cilat qytetarët përballen. "Ju e dini se sfidat mund të jenë diçka e re dhe e papërbalueshme për secilën parti tjetër, mirëpo jo për Partinë Demokratike të Kosovës. Ne kemi lindur në sfida e kohë të vështira. Por, ADN-ja jonë nuk ka të bëjë me dorëzimin para tyre, por me ngadhënjimin dhe fitoren ndaj tyre. Sot si shtet dhe shoqëri ne qëndrojmë në një udhëkryq,

ku zgjedhjet që bëjmë do të përcaktojnë të ardhmen e vendit tonë. Dhe nuk kam asnjë dyshim se ju, rinia jonë, do të na prini në rrugën e duhur", shtoi Krasniqi.

Lideri i PDK-së tha se ëndrra për Kosovën ekonomisht të zhvilluar, unitare dhe jo përçarëse, globalisht të integruar, anëtare të BE-së dhe NATO-s, është një qëllim që brezat duhet ta arrijnë së bashku. "Ne jemi të përkushtuar për t'ju fuqizuar ju në çdo hap të rrugës. Në këtë drejtim tashmë ju keni edhe kryetaren e Rinisë Demokratike të Kosovës si kandidatë për deputete. Mbështetja për të është mbështetje për vetveten tuaj sepse, mbi të gjitha, Arbnora do t'i përfaqësojë dhe mbrojtë interesat tuaja në Kuvendin e Kosovës", u shpreh Krasniqi. Ndërsa kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri

Hamza, ka thënë se ka energji e forcë për t'i thyer barrierat, për t'i shtyrë kufijtë e së mundshmes dhe për ta sfiduar Status Quo-në që kishin të rinjtë tanë. "Ne ofrojmë vizion e program për një Kosovë që u jep mundësi të rinjve, që krijon vende pune, forcon arsimin dhe garanton drejtësi për të gjithë. Dhe, demokratët e rinj, të palodhur në punë e të pandalshëm në terren, çdo ditë po e shpërndajnë këtë mesazh gjithandej Kosovës", ka thënë Hamza.

Ai ka shtuar se çdo hap që hedhin, çdo derë që trokasin dhe çdo person që bindin është një kontribut më shumë për një Kosovë që mundet ma mirë.

Kryetarja e Rinisë Demokratike të Kosovës, Arbnora Salihu, e cila është edhe kandidatë për deputete, u zotua se bashkë me të rinjtë e Kosovës do të bëhen bashkë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë.

Aktakuzë ndaj pesë zyrtarëve në Mamushë, dëmi mbi 120 mijë euro

MAMUSHË, 24 DHJETOR - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër pesë personave, të dyshuar për kryerjen e veprës penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" në bashkëkryerje.

Sipas aktakuzës ndaj S. M., F. T., E. M., F. M. dhe V. Sh, ngjarja lidhet me vlerësimin e dëmeve nga vërshimet në komunën e Mamushës më 29 janar 2021. Të pandehurit, në cilësinë e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e dëmeve,

përpiluan një listë me 169 përfitues të ndihmës financiare publike prej 416,874.77 eurosh. Nga kjo shumë, mbi 120,000 euro u përfituan në mënyrë të paligjshme nga persona të përfshirë në kundërshtim me ligjin ose që nuk ishin fare fermerë.

Kryetari i komisionit, S. M., dhe anëtarët e tij akuzohen se kanë tejkalluar kompetencat e tyre, duke përfshirë 43 fermerë në listën e përfituesve në kundërshtim me vendimet dhe opinionet ligjore, si dhe duke futur 13 persona të tjerë

që nuk ishin të kualifikuar. Këto veprime i shkaktuan buxhetit të Kosovës dëm material të konsiderueshëm. "Me këto veprime të pandehurit e lartcekur kanë kryer veprën penale 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar'", thuhet në njoftimin e Prokurorisë Themelore të Prizrenit. Prokuroria ka kërkuar nga gjykata që, pas shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, të pandehurit "të shpallen fajtorë dhe të dënohen" në përputhje me ligjin.



Përurohet rruga Zhur-Dragash-Dragash-Brod, me gjatësi 42 kilometra

DRAGASH, 24 DHJETOR - Së bashku me ministrin e Mjedisit, Planifikimit dhe Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu dhe dy zëvendësministrat në këtë ministri, Hysen Durmishi dhe Jeton Raka, kryeministri Albin Kurti bëri përrurimin e rrugës Zhur-Brod që lidh fshatrat Zhur-Dragash dhe Dragash-Brod, me gjatësi prej 42 kilometrash dhe vlerë të investimit afër 7.9 milionë euro.

Me rastin e përrurimit, kryeministri Kurti foli për rëndësinë e funksionalizimit të kësaj rruge e cila është

shumë e rëndësishme për qarkullimin e lirë, ekonominë dhe turizmin, duke shtuar se këto vise të bukura do të duhej të vizitoheshin nga mbarë Kosova. Ai falënderoi punëkryesin dhe punëtorët si dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit dhe Hapësinor dhe Infrastrukturës për punën dhe angazhimin e tyre për finalizimin e punimeve të kësaj rruge të rëndësishme jo vetëm për banorët e zonës, por edhe për gjithë qytetarët. Ministri Aliu tha se kjo rrugë e ka një rëndësi për zhvillimin ekonomik, sepse ajo e lidh vendin me Brodin ku turizmi

malor dhe dimëror e veror është duke u zhvilluar si dhe paraqet mundësi më shumë për tërheqjen e vizitorëve të brendshëm dhe nga jashtë vendit.

Ndërkaq zëvendësministri Durmishi veçoi se pjesa prej Zhurit deri në Dragash është me tri korsi, kurse pjesa tjetër është me dy korsi.

Për vitin e ardhshëm ai njoftoi se tashmë është paraparë buxhet me të cilin do të bëhet edhe rehabilitimi i rrugës prej qendrës së Dragashit deri në dalje të Dragashit me gjatësi 2.4 kilometra.



Raporti i FMN-së vlerëson sërish punën e BQK-së

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është vlerësuar lart nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) pas përfundimit të Konsultimeve të Nenit IV për vitin 2024 dhe Rishikimit të Tretë të Marrëveshjes Stand-By (SBA) dhe Marrëveshjes për Qëndrueshmëri (RSF), pas qëndrimit të misionit të FMN-së në vendin tonë nga data 28 tetor deri më 11 nëntor 2024.

Raporti i stafit të FMN-së, i udhëhequr nga David Amaglobeli - shefi i Misionit për Kosovën, ka mirëpritur progresin e bërë nga BQK në avancimin e kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës si dhe reformat e ndërmarra nga BQK për ruajtjen

e stabilitetit financiar.

Vlerësimi pozitiv i FMN-së thekson qasjen proaktive të BQK-së në forcimin e qeverisjes, stabilitetit dhe qëndrueshmërisë financiare, pagesave digjitale, si dhe reformat e ndërmarra për harmonizim me standardet dhe praktikën e zbatuara në Bashkimin Evropian.

Për më tepër, FMN-ja vlerësoi progresin e BQK-së në avancimin e kuadrit ligjor përmes Ligjit të ri për Bankat, i cili ka vendosur bazën për praktika moderne rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe Ligjit për Shërbimet e Pagesave, përveç forcimit dhe avancimit të mbikëqyrjes bankare. Gjithashtu, thekson se



modernizimi i procesit të mbikëqyrjes bankare, përfshirë Procesin e Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës (SREP), është në përputhje me kuadrin mbikëqyrës të zbatuar nga Autoritetet Mbikëqyrëse

Evropiane.

Sipas raportit, sektori bankar mbetet i shëndetshëm - fitimprurës dhe mirë i kapitalizuar, me nivele të ulëta të kredive joperformuese dhe potencial të konsiderueshëm

për zgjerim.

Largimi i tarifave për llogaritë bazike bankare dhe masat administrative për ta luftuar informalitetin kanë kontribuar në rritjen e qasjes në financa dhe kredive për ekonominë familjare.

Raporti thekson se programi ka përfunduar mirë, të gjitha kriteret e performancës kuantitative dhe treguesit kyç për rishikimin e tretë të Marrëveshjes Stand-By janë përmbushur.

Në përfundim, BQK-ja shpreh mirënjohjen e saj për ekipin e FMN-së për bashkëpunimin konstruktiv dhe mbështetjen në formën e asistencës teknike për avancimin e procesit të reformave.

KEDS-i: Rritja tej mase e konsumit të rrymës ka shkaktuar një varg mbingarkesash në Kosovë



PRISHTINË, 24 DHJETOR - KEDS-i ka njoftuar se rritja tej mase e konsumit të energjisë elektrike ka shkaktuar një varg mbingarkesash në shumë pjesë të Kosovës. "Mbingarkesa, si e tillë, po shkakton telashe në disa zona kyçe. Si rrjedhojë, një pjesë e konsumatorëve janë duke u ballafaquar me sfida të furnizimit me energji elektrike, pasi po rrezikohen asetet dhe po vjen deri te djegia e tyre që, si pasojë, konsumatorët po mbesin për një kohë pa energji elektrike deri në zëvendësimin

e aseteve, ku në raste të caktuara përfshijnë kabllo të deri te transformatori. Por, edhe në këto rrethana, po arrijmë t'i furnizojmë mbi 95 për qind të konsumatorëve në vazhdimësi, krejt kjo si rezultat i investimeve të vazhdueshme në rrjet", ka njoftuar KEDS-i.

Sipas KEDS-it, konsumi që po arrin nivele rekorde historike deri në 1500MW/h, i cili, krahasuar me vitin 2013, kur KEDS-i kishte filluar së operuari, ishte rreth 1000MW/h, përveçse po

përballohet në masë të madhe falë këtyre investimeve, po mbulohet komplet nga prodhimi vendor dhe importi, i cili po arrin deri në 500 megavatë në orë. "Bashkëpunimi juaj është thelbësor në këto ditë. Apelojmë tek të gjithë konsumatorët që të bëjnë kursim maksimal të energjisë, posaçërisht të kujdesen për ngrohjen me rrymë, në mënyrë që të lehtësohet gjendja dhe rrjeti distributiv ta përballojë më lehtë", ka njoftuar KEDS-i.

ATK-ja digjitalizoi certifikatën e rezidencës tatimore


PRISHTINË, 24 DHJETOR - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se më 1 janar 2025 do ta publikojë versionin e ri të Sistemit Elektronik EDI, përmes të cilit do të ofrohet edhe një shërbim i ri elektronik, gjegjësisht pajisja me Certifikatë të Rezidencës Tatimore - CRT. Certifikata e Rezidencës Tatimore është një dokument zyrtar që konfirmon

vendbanimin e individit apo biznesit për qëllime tatimore. Ky dokument është thelbësor për: eliminimin e tatimit të dyfishtë për tatimpaguesit që realizojnë të hyra jashtë vendit; mundësimin e lehtësirave tatimore në marrëdhëniet ndërkombëtare, veçanërisht me vendet me të cilat Kosova ka në zbatim Marrëveshje për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD); njohjen

dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve tatimore, të tatimpaguesve të Kosovës, në vendet e tjera. "Ky shërbim i ri elektronik ka për qëllim lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit, duke ofruar një mënyrë më të shpejtë dhe efikase për t'u pajisur me Certifikatën e Rezidencës Tatimore", ka njoftuar ATK-ja.



Biri i Zotit?



Shekulli i IV ishte një periudhë vendimtare për krishtërimin, teksa duhej të jepte përgjigje për një pyetje thelbësore: Çfarë ishte Jezusi? Të krishterët e dinin kush ishte Jezusi—jeta, vdekja dhe ringjallja e tij ishin themelet e besimit të tyre. Por Perandoria Romake ishte thellësisht e ndarë rreth asaj, çfarë ishte Jezusi. Përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje do të përcaktonte jo vetëm teologjinë, por edhe unitetin e Kishës dhe vendin e saj në perandori.

Jezusi si Zot dhe njeri

Jezusi e quajti veten Biri i Njeriut dhe Biri i Zotit. Kisha e hershme e shpalli atë njëkohësisht Zot dhe njeri, një figurë hyjnore që krijoi qiëjt dhe tokën, por që gjithashtu jetoi dhe vuajti si një qenie njerëzore. Ky pretendim e veçonte nga praktika e zakonshme romake ku perandorët dhe figura të tjera shpallehin perëndi. Ndryshe nga këto pretendime tokësore për hyjnizim, Jezusi përshkruhej si I vetmi Zot i vërtetë që u bë njeri.

Kjo ngjalli një pyetje qendrore: A mundet Krijuesi i gjithpushtetshëm të marrë me të vërtetë mbi vete dobësitë njerëzore, të jetojë në varfëri dhe të vdesë në një kryq? Për shumë, kjo ishte e vështirë për t'u pranuar. Një alternativë më e arsyeshme për disa ishte ideja që

Zoti të dërgonte një përfaqësues për të kryer këtë mision – një krijesë e krijuar nga Zoti për këtë qëllim.

Sfida e Arianizmit

Kjo ishte pikërisht teza e propozuar nga prifti Arius (256–336 pas Krishtit). Ai argumentoi se Jezusi nuk ishte Zot në kuptimin e plotë, por një qenie e krijuar nga Zoti për të përmbushur një mision hyjnor. Kjo ide u përhap shpejt, veçanërisht midis njerëzve që nuk kishin reflektuar thellë mbi detajet e besimit të tyre.

Megjithatë, për peshkopët e Kishës, këto “detaje” ishin themeli i besimit. Në vitin 325, Perandori Konstandini thirri Këshillin e Nikeas për të zgjidhur këto çështje doktrinale. Ndër pjesëmarrësit ishte edhe Peshkopi i Myrës, Nikolla – i njëjti Shën Nikollë që sot lidhet me dhuratat e Krishtlindjes. Nikolla ishte i ashpër ndaj besimeve heretike të arianëve, dhe një tregim thotë se ai madje goditi një nga heretikët gjatë diskutimeve.

Formula e besimit të Nikeas



Çështja ishte jetike: Nëse Jezusi nuk ishte Zot në kuptimin e plotë, atëherë shpengimi i tij nuk ishte gjithëpërfshirës. Për më tepër, lindja e tij njerëzore, e

festuar në Krishtlindje, nuk do të kishte të njëjtën rëndësi. Pas shpërthimit të tij, Nikolla u burgos dhe iu hoqën titujt e peshkopit. Por, sipas një legjende, ai pati një vizion të Jezusit dhe Marisë, të cilët i dhanë një libër ungjijsh dhe një rrobë priftërore.

Të nesërmen, rojet e gjetën Nikollën të veshur mrekullisht si peshkop dhe duke lexuar Shkrimet. Pas kësaj ngjarjeje, Këshilli vendosi të mernte anën e tij dhe shpalli se Jezusi ishte vërtetë Zot. Ata formuluan Kredon Nikeane për të shprehur këtë besim, duke vulosur doktrinën e Trinisë së Shenjtë.

Trashëgimia dhe Krishtlindja

Arianizmi vazhdoi të ekzistonte për dy shekuj ndër fiset gjermanike që kishin pushtuar Evropën Veriore, duke bërë që Krishtlindja të mos kish rëndësi të madhe atje. Por kur Karli i Madh u kurorëzua si Perandor i Shenjtë Romak në Romë, në Ditën e Krishtlindjes të vitit 800, fiset gjermanike përqaftuan Kishën Katolike dhe u përkushtuan si mbrojtës të saj. Krishtlindja, Perandoria dhe Roma u bashkuan në perandorinë që Frankët po ringjallnin, duke vulosur rëndësinë e Jezusit si Zot dhe njeri në traditën e krishterë. / bota.al



Takim informues mbi Ligjin e Sponsorizimit për klubet e futbollit

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Në një takim të organizuar në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës, zëvendësudrejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Sami Salihu, paraqiti hollësitë e Ligjit për Sponsorizim për klubet e Superligës dhe Ligës së Parë. Ky takim kishte për qëllim informimin e klubeve për procedurat dhe përfitimet që ofron ky ligj, duke i udhëzuar ata për shfrytëzim të drejtë të tij. Ai në hollësi ofroi aspekte specifike të trajtimit tatimor të Ligjit të Sponsorizimeve. Ai sqaroi si mund të përfitojnë klubet nga zbritjet tatimore dhe theksoi rëndësinë e përgatitjes së dokumentacionit të rregullt. Sponsorizimet për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit trajtohen si shpenzime të zbritshme deri në 10 % të të



ardhurave të tatueshme. E për të përfitur nga ky ligj klubet duhet t'i përmbushin të gjitha kriteret dhe procedurat ligjore në mënyrën e duhur. Në takim ishte i pranishëm edhe presidenti i FFK-së, Agim Ademi, i cili falënderoi ATK-në për bashkëpunimin dhe

nënvizoi rëndësinë që ky ligj ka për zhvillimin dhe mbështetjen e futbollit kosovar. Ky takim kishte për qëllim ta ofrojë mbështetjen konkrete për klubet në aspektin e procedurave sa i përket ATK-së rreth përfitimit nga ky ligj.

Yakin: Xhaka lider i madh, po përgatitet për karrierën trajner

CYRIH, 24 DHJETOR - Trajneri i Kombëtares së Zvicrës, Murat Yakin, ka lavdëruar qasjen prej një lideri të padiskutueshëm të Granit Xhakës në kombëtaren helveteke. Ai ka pranuar se për shumë gjëra taktike në skuadër konsultohet me Xhakën. "Ne përfshijmë këshillin e lojtarëve dhe përgatitëm lojtarët për ndeshje. Lojtarët me përvojë, gjithashtu, duhet të marrin përgjegjësi. Fjala e lojtarëve me përvojë ka një peshë të madhe. Kur një Granit Xhaka ose një Manuel Akanji thonë diçka, një lojtar i ri zakonisht dëgjon. Veteranët duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë", ka thënë Yakin. Ai ka zbuluar pastaj se Xhaka po përgatitet për t'u bërë trajner i futbollit. "Ai tashmë po përgatitet për të ardhmen e tij trajner. Jo vetëm për sa i përket



përbajtjes së stërvitjes taktike, por edhe si të drejtosh një ekip. Kjo është më shumë se të jesh kapiten. Ai është jashtëzakonisht i interesuar për këtë. Kur shihemi, ai dëshiron të dijë shumë. Kemi regjistruar edhe formacionet në letër dhe kemi diskutuar tema taktike. Ai bën shumë pyetje. Për shembull

ka të bëjë me çështjet e lojtarëve nga e kaluara. Për lojtarët që shkaktuan probleme. Ose për situata të vështira si trajner, si ajo që më ndodhi kur vendosa Alex Frein në stol. Si i trajtoni lojtarët e moshuar që po i afrohen fundit të karrierës e kështu me radhë", ka shtuar Yakin.

SHKURT

Muriqi mund të rikthehet te Fenerbahçe

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, mund të kthehet te skuadra e Fenerbahçes, shkruan mediumi turk "Aspor". 30-vjeçari ka kontratë me klubin e Mallorcas deri në vitin 2027, por mund ta zëvendësojë sulmuesin Youssef En-Nesyri, i cili pritet të largohet gjatë janarit, pasi ka pranuar ofertë nga Arabia Saudite. Fenerbahçe pritet të fitojë 30 deri 35 milionë euro nga shitja e En-Nesyrit dhe pritet të shpenzojë 10 milionë euro për transferimin e Vedat Muriqit, shkruan mediumi turk. Muriqi shkëlqeu në Turqi, ndërsa në edicionin aktual me fanellën e Mallorcës ka shënuar tre gola dhe ka kontribuar me dy asistime në 14 paraqitje në La Liga.

Rrahmani në formacionin e javës në Serinë A

Amir Rrahmani pati një paraqitje fantastike me Napolin në këtë fundjavë. Napolitanët triumfuan 1-2 në udhëtim ndaj Genoas, derisa Amir Rrahmani shënoi golin e dytë të mysafirëve në këtë përballje. Pas golit dhe paraqitjes mjaft të mirë, kapiteni i Kosovës ka siguruar një vend në formacionin e javës së 17-të të Serisë A. Formacioni: Turati, Holm, Rrahmani, Augusto, Aguello, Paredes, Saelemaekers, Dybala, De Ketelaere, Yildiz, Dovbyk.

Korenica në formacionin e javës në Rumani

Mesfushori Meriton Korenica ka vazhduar shkëlqimin me CFR Cluj në Rumani, duke e gjetur veten përsëri në formacionin më të mirë të javës. CFR Cluj ka fituar me rezultat 3-2 ndaj Otelulit në ndeshjen e vlefshme për javën e 21-të në Superligën e Rumanisë. Një nga më meritoret në këtë fitore të vendasve ishte ylli kosovar Korenica, i cili shënoi një gol dhe asistoi për një tjetër. Paraqitja e tij brilante bëri që Korenica të notohet me 9 dhe të përfundojë si pjesë e formacionit më të mirë të javës në "SofaScore". Vlen të theksohet se Korenica në 20 ndeshje deri tani këtë sezon ka shënuar 3 gola dhe ka asistuar 3 herë.

Egnatia dhe Kukësi luftojnë për trofeun e parë të sezonit

Më 26 dhjetor, në orën 19:00, në stadiumin "Arena Kombëtare" do të luhet Superkupa e Shqipërisë, e 31-ta në histori. Egnatia si kampione e Shqipërisë dhe fituese e Kupës, ndërsa Kukësi si finalist i Kupës së Shqipërisë do të përballen me njëra-tjetrën në këtë duel të veçantë për trofeun e parë të sezonit 2024/2025. Vetëm dy ditë kanë mbetur nga Superkupa e Shqipërisë, teksa rrogzhinasit pas titullit kampion dhe Kupës së Shqipërisë synojnë trofeun e parë në histori të Superkupës. Kukësi ndërkohë e ka fituar vetëm një herë më parë Superkupën dhe kuksianët do të tentojnë trofeun e dytë në histori.

Cavaliersi e Oklahoma dominojnë, humbje zhgënjyese për Bostonin dhe lakersat

OHIO, 24 DHJETOR - Nuk gabojnë kryesuesit e Konferencave në NBA. Ekipi i Clevelandit dominon renditjen e Konferencës së Lindjes pas fitores me rezultat 124-113 ndaj Utah Jazzit. Katër lojtarë të Cavaliersit realizuan mbi 20 pikë, duke bërë diferencën në parket. Më i miri për Cavaliersin ishte Mobley, i cili realizoi 22 pikë dhe kapi 10 topa në tabelë. Në përfundim të ndeshjes së parë ndodhet ekipi i Oklahomës, që fitoi me shifrat 123-105 ndaj Washingtonit. Tjetër ndeshje e

mirë për Alexander Shai, me kanadezin që realizoi 41 pikë dhe kapi 9 topa në tabelë për vendasit. Zhgënjyeshme edhe për Denver Nuggetsin, që fitoi me shifrat 117-90 ndaj Phoenixit, sfidë ku shkëlqeu sërisht Nikola Jokiq, autor i 32 pikëve. Humbasin në mënyrë befasuese edhe kampionët në fuqi të Boston Celticsit. Orlando Magic arriti ta surprizonte Celtsin me shifrat 108-104. Në Florida ndeshja vendoset në minutat e fundit. Nuk mjaftuan 35 pikët e Jalen Brownit për miqtë, për të shmangur një tjetër

vendase Stephen Curry zhgënjyeshme duke shënuar vetëm 10 pikë. Fitorë shumë e rëndësishme edhe për Denver Nuggetsin, që fitoi me shifrat 117-90 ndaj Phoenixit, sfidë ku shkëlqeu sërisht Nikola Jokiq, autor i 32 pikëve. Humbasin në mënyrë befasuese edhe kampionët në fuqi të Boston Celticsit. Orlando Magic arriti ta surprizonte Celtsin me shifrat 108-104. Në Florida ndeshja vendoset në minutat e fundit. Nuk mjaftuan 35 pikët e Jalen Brownit për miqtë, për të shmangur një tjetër



humbje që e largon nga kryesuesit e konferencës, Clevelandit. Për Magicun më i

REZULTATET	
Charlotte - Houston	101-114
Cleveland - Utah Jazz	124-113
Orlando - Boston	108-104
Philadelphia - San Antonio	111-106
Atlanta - Minnesota	117-104
Miami - Brooklyn	110-95
New York - Toronto	139-125
Chicago - Milwaukee	91-112
Memphis - Clippers	110-114
Oklahoma - Washington	123-105
Dallas - Portland	132-106
Denver - Phoenix	117-90
Golden State - Indiana	105-111
Lakers - Detroit	114-117

dalluari ishte Tristan de Silva që shënoi 18 pikë dhe, mbi të gjitha, për faktin se realizoi një trepikësh në sekondat e fundit të ndeshjes.


Fury: Usyku mori një dhuratë të madhe nga gjyqtarët për Krishtlindje

LONDËR, 24 DHJETOR - Boksieri britanik Tyson Fury pretendon se ai është "grabitur" nga gjyqtarët pasi humbi me vendim unanimit të gjyqtarëve revanshin ndaj Oleksandr Usyk, në duelin e zhvilluar më 21 dhjetor në Riad të Arabisë Saudite. Ukrainasi fitoi me vendim shumice sfidën e parë në

maj, ndërsa këtë herë të tri gjyqtarët i dhanë fitoren, duke shënuar 116-112 në favor të tij. Pas mbërritjes në Londër, boksieri britanik foli sërish për këtë çështje: "Aty më grabitën titullin. Betohe për Zotin që mendova se e fitova me të paktën tre raunde. Isha unë ai që e drejtoja duelin, ndaj

nuk e kuptoj këtë vendim. Unë nuk do të qaj për këtë vendim. Mendoj se njerëzit e panë se kush ishte fitues". "Unë kam qenë në boks gjithë jetën time dhe nuk mund të ndryshosh asnjë vendim, por gjithmonë do të ndihem i vjedhur. Kur nuk fiton dot me KO është e vështirë të kesh një fitore të

garantuar", ka shtuar Fury. Më tej, boksieri britanik ka deklaruar: "Mendoj se i fitova të dyja ndeshjet. Nuk ka dyshim që e fitova këtë luftë. Mendoj se Usyk mori një dhuratë të bukur për Krishtlindje nga gjyqtarët. Tani do të pushoj dhe më pas do të mendoj për të ardhmen".



Tri ndeshje pa shënuar gol, Lewandowski: Më mungon qetësia

BARCELONË, 24 DHJETOR - Ky fundvit nuk ka qenë ashtu siç do të kishin dashur te Barcelona. Rezultatet zhgënjyese të njëpasnjëshme kanë bërë që skuadra të lëshojë kreun pikërisht në ndeshjen e fundit të vitit. Dhe rrezikon ta gjejë veten -6 nga Atletico dhe -5 nga Reali, nëse dy ekipet e Madridit fitojnë takimet e tyre të prapambetura. Ndaj te Barcelona është kohë reflektimi dhe marrje përgjegjësish. Me radhë, Rafinha, Cubarsi, Pedri, Flick e kanë kuptuar se diçka nuk shkon dhe shumë gjëra duhen përmirësuar. Listës së fundmi i është bashkuar dhe Robert Lewandowski. Polaku ishte i radhës që ka bërë "mea culpa". Në dy ose tri ndeshjet e fundit kemi pasur raste të shumta të pastra që i kemi shpërdoruar. Unë vetë kam pasur ndjenjën se më ka munguar pak qetësia në zonë dhe ndoshta besimi në veten time", ka thënë sulmuesi në një deklaratë për "Liga TV".

Qendërsulmuesi i Barçës vazhdon të jetë golashënuesi më i mirë i skuadrës dhe i kampionatit me 16 gola, por në tri ndeshjet e fundit mes kampionatit dhe Ligës së Kampionëve nuk ka shënuar asnjë gol. Seria e tij e shkëlqyer është ndalur. Leva pranoi ndjesitë e këqija me të cilat katalanasit shkojnë në pushime për shkak të humbjes ndaj një rivali të drejtpërdrejtë në garën për titull, Atletico Madrid. "Mendoj se skuadra është edhe më e zemëruar, sepse në pjesën e parë zhvilluam një lojë shumë të mirë. Në ishim shumë të mirë edhe në pjesën e dytë. Ne ishim të mirë por, për shkak të gabimeve tona, Atletiko krijoi raste dhe shënoi dy gola. Ne nuk luajtëm keq, por sido që të luani, nëse nuk i shfrytëzoni mundësitë tuaja, bëhet e vështirë të fitoni. Dhe kjo shpjegon humbjen. Në minutat e fundit ne luajtëm sikur të ishim në një finale dhe e



humbëm ndeshjen pasi po kërkonim të shënonim me çdo kusht. Definitivisht nuk duhet ta kishim humbur këtë takim", ka shtuar polaku. Sulmuesi veteran ishte i bindur, megjithatë, se grupi do të dijë të kapërcejë dhe të gjithë do ta rikuperojnë versionin e tyre më të mirë. "Mendoj se kjo humbje ka shërbyer si një mësim për ne. Ndonjëherë, nëse nuk fiton, nuk duhet të humbasësh. Na ka ndodhur disa herë këtë sezon. Mendoj se vitin e ardhshëm do të kthehem më të fortë dhe do të luajmë futboll më të mirë", ka thënë ai.

Së fundi, Lewandowski iu referua rëndësisë së përqendrimit dhe përgatitjes kur kalendari është kaq i ngjeshur dhe kërkues. "Kur e krahasoj veten tani me atë se si isha disa vjet më parë, më kujtohet se po mësoja, gjithashtu. Ndonjëherë fitorja më mbetej në kokën time, por më duhej të luaja dy-tri ditë më vonë dhe ndonjëherë më mungonte përqendrimi. Kur lojtarët e një moshe të caktuar luajnë çdo tri ditë, mendoj se gjëja më e rëndësishme është përgatitja. Kjo ndeshje ka mbaruar, ju duhet të përgatiteni për tjetrën, dhe kjo është gjëja më e rëndësishme".

SHKURT

Dy klube interesohen për Uzunin

Myrto Uzuni po kalon në formë të mirë me Granadën në këtë sezon. Sulmuesi i Kombëtares shqiptare është kthyer në idhullin e tifozëve, ndërsa qëndron si lojtari i huaj që ka shënuar më shumë gola në histori të klubit. Për këtë dhe ka tërhequr vëmendjen, pasi dy klube raportohet të jenë pas tij. Bëhet fjalë për Seattle Sounders në Amerikë si dhe Sevillan. Spanjollët kanë qenë të interesuar edhe më herët për shërbimet e sulmuesit shqiptar. Kontrata e 29-vjeçarit me Granadën përfundon në verën e vitit 2026. Për këtë klubi spanjoll mund të përfitojë disa milionë euro nga shitja e kartonit. Katër milionë euro u shpenzuan tre vjet më parë për blerjen nga Ferencvarosi.

Mick Schumacher heq dorë: Nuk ia vlen të pres më për një makinë në Formula 1

Pas dy vitesh si pilot i Hassit në Formula 1, gjermani Mick Schumacher kaloi dy sezone si pilot rezervë i Mercedesit. Ai priste që vitin e ardhshëm të rikthehej në pistë, por asnjë skuadër nuk i hapi derën. Për pasojë, ai vendosi të mos shpësojë më për një vend në Formula 1. Aktualisht pa skuadër, kampioni i botës në Formula 2 në vitin 2020 është i paqartë për të ardhmen e tij, por duket se ka pëlqyer të garojë në WEC. "Mendoj se kam marrë një vendim të drejtë. Të pres ende për një vend në Formula 1 më duket humbje kohe. Nuk pata fatin të rikthehem edhe pse mendoj se e meritoja një shans të tillë", ka thënë Mick Schumacher.

Musiala: Ramosi ishte kundërshtari më i vështirë

Jamal Musiala, lojtari më në formë aktual te Bayern Munchenit, është pyetur për kundërshtarin më të fortë që ka pasur ndonjëherë në futboll. Zgjedhja e tij ishte mjaft e parashikueshme. Emri i përmendur, Sergio Ramos. Sipas gjermanit, ish-mbrojtësi i Real Madridit ka qenë më i vështiri në dueltë tek për tek. "Kam luajtur kundër Sergio Ramosit kur isha paksa më i ri. Ishte shumë i vështirë për mua. Jam surprizuar nga mënyra se si mbronte ai. Ishte shumë intuitiv dhe shumë i fortë në ndërhyrje", ka thënë Musiala.

Trajneri i Unitedit: Do ta mbështes gjithmonë Rashfordin

Trajneri Ruben Amorim la jashtë skuadrës Marcus Rashford për tri ndeshjet e fundit të Manchester Unitedit. Rreth situatës së lojtarit, e cila mbetet ende e turbullt, ka folur tekniku Amorim. "Është një situatë e vështirë. E kuptoj që këta lojtarë kanë shumë njerëz rreth tyre, të cilët marrin vendime që nuk janë ideja e parë e vet futbollistit. Unë jam gjithmonë këtu për ta ndihmuar Marcusin", ka thënë ai. Kujtojmë se Rashfordi u shpreh para disa ditësh se është gati për një sfidë të re dhe nëse do të largohej, nuk do të fliste kurrë për Manchester Unitedin.

Guardiola: Asnjë lojtar nuk do të largohet në janar

Trajneri Pep Guardiola nuk beson se Manchester City do t'i lërë lojtarët të largohen në merkaton e janarit, pavarësisht performancës së

dobët të disa prej lojtarëve të tij, për shkak se skuadra po përballet me një numër të madh lojtarësh të dëmtuar, çka ka ndikuar edhe në

rezultatet e dobëta të javëve të fundit. "Unë nuk mendoj se do të ketë largime në merkaton e janarit. Për momentin kam nevojë për të gjithë ata që janë

këtu. Vetëm në fund të sezonit do ta vlerësojmë situatën. Kam një ndjenjë që skuadra është vërtet e mirë, por dua që lojtarët e mi të kthehen të

luajnë ashtu si duhet. Ekipi është ky që është. Klubi do të vendosë se çfarë është më e mira për ekipin", ka thënë Guardiola.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

THIRRJE PËR APLIKIM

Kompania "Koral Dairy" Sh.p.k. kërkon një ofertues/kontraktor apo kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për furnizim me paisje si më poshtë:

1. Homogjenizator 5000-6000 l
2. Paketuese për gjizë
3. Mbushës për gjizë
4. Dezobarier
5. Pirunjer
6. Sistem automatik për pastrim
7. Karroca për bartjen e gjizës

Kompanitë e interesuar duhet të kontaktojnë direkt te përfituesi "Koral Dairy sh.p.k." nëpërmjet e-mailit apo telefonit, për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë.

Ftesat për Kuotim mund të merren më së largu deri me 30 Dhjetor 2024.

Përfituesi: Kompania "Koral Dairy" sh.p.k.

Adresa: Miradi e Epërme -Fushë Kosovë

Telefoni: +383(44) 277 548

E-maili: sales@koraldairy.com

Ofertat/propozimet duhet të dorëzohen tek adresa e përfituesit më së largu deri me 10 Janar 2025.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Labinot Haziri nga Prishtina shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e Gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

Ardian Bozhegu nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit "Ardian Pozhegu" B.I. Me nrb: 810244012.

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Blenda Gashi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi".

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Lumë's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumescdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

